

VENDIM
Nr.2, datë 1.7.2005

PËR DHËNIEN E LEJES PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SI INSTITUT
PRIVAT PENSIONESH SUPLEMENTARE

Mbështetur në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensione", (të ndryshuar)", si dhe në vendimin nr.908, datë 29.12.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve Suplementare dhe për procedurat e licencimit dhe të mbikëqyrjes"", Inspektorati i Instituteve Private të Pensioneve Suplementare, pasi:

- a) ka vlerësuar të gjithë dokumentacionin e paraqitur duke analizuar të gjithë informacionin e siguruar prej tij;
- b) ka diskutuar me bordin drejtues të institutit për objektivat e këtij instituti në treg, planbiznesin e paraqitur, kapitalizimin e propozuar të institutit, organizimin e tij, projektet financiare të institutit për tri vitet e ardhshme, politikat kryesore të investimeve të propozuara etj.;
- c) ka vlerësuar, në bazë të planbiznesit të paraqitur, të rejat që do të sjellë instituti në treg, si dhe parashikimin e mbijetesës së tij në kushtet e ekzistencës së konkurrencës së lirë në treg;
- d) ka vlerësuar planbiznesin e paraqitur dhe konstaton se ai është real dhe bindës;
- e) ka vlerësuar mundësinë e aksionarëve të propozuar të institutit për të shtuar kapitalin, në qoftë se do të jetë i nevojshëm për të mbuluar humbjet, që mund të rezultojnë nga ushtrimi i veprimtarisë si institut pensionesh;
- f) ka shqyrtuar transparencën e burimeve dhe të strukturës së kapitalit aksionar të institutit; g) ka vlerësuar strukturën organizative dhe ambientet e shërbimit të institutit të propozuar;
- h) është siguruar se pjesëtarët e bordit drejtues dhe të stafit ekzekutiv të institutit privat të pensioneve suplementare të propozuar, janë të aftë profesionalisht;
- i) ka vlerësuar dhe ka verifikuar opinionet e dhëna nga publiku për kërkesën e paraqitur;

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e paraqitur për zhvillimin e veprimtarisë si institut privat pensionesh suplementare të llojit i hapur për subjektin IAPPSSH SHA.

2. Subjekti IAPPSSH SHA, pas dhënies së lejes, si dhe pas regjistrimit në regjistrin tregtar si shoqëri anonime, detyrohet të fillojë veprimtarinë si institut privat pensionesh suplementare brenda datës 30.9.2005.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Naim Hasa